



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT  
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE  
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti I ministrit

Cabinet of the minister

Kabinet ministra

## Udhëzimi Administrativ

**Për mbajtjen e rizgjedhjeve të plota dhe përmbylljen e rivendosjes së qeverisjes së ligjshme në Universitetin e Prishtinës.**

**NUMËR: MASHT 11/2006**

**Datë: 26.04.2006**

Në bazë të nenit 1.3 pika ç) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 Mbi e Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 4.1 paragrafët (b) dhe (m) të Ligjit mbi Arsimin e Lartë, dhe në bazë të nenit 17 paragrafët (1) dhe (2) të Statutit të Universitetit të Prishtinës, dhe pika V. e Udhëzimit Administrativ Nr. MASHT [I] 37/2005 për rivendosjen e qeverisjes së ligjshme në Universitetin e Prishtinës dhe U.A. nr. 8/06,

Duke marrë parasysh analizat e ekspertit për rastet e mospërputhshmërisë me kornizën ligjore gjatë proceduarve zgjedhore, të mbajtura në UP në mes 9 Korrikut dhe 1 Dhjetorit 2004,

Duke marrë parasysh raportin e dytë të Grupit të Ekspertëve të UP-së për qeverinë, Në harmoni me politikat e Qeverisë së Kosovës për vendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në Universitetin e Prishtinës,

Bazuar në vendimin e Qeverisë së Kosovës të takimit të 26 Korrikut 2005 për rivendosjen e qeverisjes dhe udhëheqësisë së ligjshme në UP, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nxjerr këtë Udhëzim Administrativ :

### Neni 1

Komisioni qendror zgjedhor i UP të themelohet brenda 3 ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi dhe të përbehet nga tre anëtarë:

- Një ekspert për zgjedhje, i emëruar nga OSBE
- Një ekspert i statutit, i emëruar nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Sekretari i Përgjithshëm i UP

## Neni 2

1. Komisioni zgjedhor i fakultetit në përbërje prej tre anëtarëve duhet të themelohet në secilin prej 17 fakulteteve brenda 5 ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi:

- a. Një ekspert për zgjedhje, i emëruar nga OSBE
- b. Një profesor i respektuar i fakultetit, i emëruar nga këshilli i fakultetit
- c. Sekretari i fakultetit

2. Komisionet zgjedhore të 17 fakulteteve do të koordinohen nga komisioni qendror zgjedhor dhe duhet të raportojnë pranë komisionit qendror zgjedhor për procedurat dhe rezultatet.

## Neni 3

1. Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të organizojnë mbajtjen e procedurave zgjedhore në bashkëpunim me Zyrat e Lartë të Ngarkuar dhe organet përkatëse qeverisëse, duke iu përmbajtur dinamikës dhe afateve ashtu si janë vendosur më poshtë dhe duke u bazuar në rregulloret përkatëse të statutit, Komisionit Qendror Zgjedhor duhet ti caktohet autoriteti i domosdoshëm administrativ në kontekstin e bazës së përkohshme.

- a. Përfaqësuesit e profesorëve në të gjitha 17 këshillat e fakulteteve → Java e 19 e vitit 2006
- b. Përfaqësuesit e asistentëve në të gjitha 17 këshillat e fakulteteve → Java 19
- c. Përfaqësuesit e personelit jo-akademik në të gjitha 17 këshillat e fakulteteve → Java 19
- d. Përfaqësuesit e personelit akademik të Senatit në të gjithë universitetin → Java 19
- e. Përfaqësuesit e personelit jo-akademik të Senatit në të gjithë universitetin → Java 19
- f. Kryesuesit e përkohshëm të këshillave të fakulteteve dhe të Senatit → Java 20
- g. Përfaqësuesit e Dekanëve në Senat → Java 20
- h. Listën e ngushtë deri në tre kandidatë për Dekan nga secili këshill fakulteti → Java 20
- i. Dekanin e secilit fakultet nga Senati → Java 21
- j. Pesë anëtarë të Këshillit Drejtues nga Senati → Java 21
- k. Listën e ngushtë deri në pesë kandidatë për Rektor nga Senati → Java 24
- l. Rektori nga Këshilli Drejtues → Java 24
- m. Pro-Rektorët nga Këshilli Drejtues → Java 25

2. Për çdo vonesë në dinamikë duhet të raportohet te Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, duke e informuar plotësisht.

3. Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet ti jepet autoriteti për zgjatjen e periudhës së veprimit të organeve qeverisëse të Universitetit të Prishtinës deri me 15 Korrik 2006 më së voni, me qëllim të sigurimit që zgjedhja e Rektorit të kompletohet brenda vitit akademik 2005/2006

#### **Neni 4**

Secila procedurë zgjedhore sipas pikës C. e këtij udhëzimi administrativ duhet të koordinohet nga komisioni qendror zgjedhor dhe të monitorohet nga Grupi i Ekspertëve i UP.

#### **Neni 5**

1. Sekretari i Përgjithshëm i UP në bashkëpunim me ekspertin e statutit, të komisionit qendror zgjedhor duhet të fillojë dhe përfundojë me kohë të gjitha përgatitjet e domosdoshme zgjedhore ashtu si përshkruhet në standardet ndërkombëtare:

- a. Listat e votuesve për secilën procedurë zgjedhore, të publikuara
- b. Listat e kandidatëve për secilën procedurë zgjedhore, të nënshkuara dhe publikuara
- c. Një rregullore obliguese zgjedhore për zgjedhje në Senat dhe këshilla të fakulteteve
- d. Infrastrukturën për mbajtjen e zgjedhjeve

2. Sekretarët e 17 fakulteteve të UP obligohen që të ofrojnë listat e kompletuara të personelit akademik dhe jo-akademik në formatin e kërkuar brenda 48 orëve pas kërkesës së dorëzuar pran tyre nga Komisioni Qendror Zgjedhor.

#### **Neni 6**

Komisioni Qendror Zgjedhor në bashkëpunim me Senatin duhet të rishpallin konkursin për pozitën e Rektorit pa ndonjë vonesë pas rivendosjes së plotë të ligjshmërisë në Senat sipas nënpikave a.-i. të pikës C. të këtij udhëzimi administrativ (→ java 20).

#### **Neni 7**

Seancat e dëgjimeve për kandidatët për Rektor duhet të organizohen nga Komisioni Qendror Zgjedhor në bashkëpunim me Senatin në mënyrë të atillë që të mundësohet respektimi i dinamikës sipas pikës C. të këtij Udhëzimi Administrativ (→ java 23).

#### **Neni 8**

Grupi i Ekspertëve duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ 37/2005 dhe 8/2005, duhet të vazhdojë monitorimin e funksionimit të Zyrtarëve të Lartë të Ngarkuar dhe duhet të raportojë për të rejat dhe për çdo hap të përmbushur zgjedhor sipas pikës D. të këtij Udhëzimi Administrativ.

#### **Neni 9**

Të 17 këshillat e fakulteteve të UP, duhet të vazhdojnë të funksionojnë sipas statusit të përkohshëm dhe mund të mbajnë mbledhje dhe vendosin vetëm për rastet nën urgjencë administrative që kanë të bëjnë me funksionimin ditor të fakultetit. Duhet ti shmangen çdo lloj

veprimi tjetër derisa të bëhet rivendosja e ligjshmërisë përmes zgjedhjeve, si më lartë. Duhet ti shmangen çdo lloj vendimi strategjik apo zgjedhjeje.

#### **Neni 10**

Senati i UP duhet të rifillojë funksionimin nën statusin e përkohshëm pas zgjedhjes së shtatë anëtarëve student nga Parlamenti Studentor në pajtim me procedurat e përshkruara në statut dhe vetëm atëherë mund të thërras mbledhje dhe vendosë vetëm për rastet nën urgjencë administrative që kanë të bëjnë me funksionimin ditor të universitetit. Duhet të i shmangët çdo lloj veprimi tjetër derisa të bëhet rivendosja e ligjshmërisë përmes zgjedhjeve, si më lartë. Duhet ti shmangët çdo lloj vendimi strategjik apo zgjedhjeje.

#### **Neni 11**

Në rast të shkarkimit apo dorëheqjes me shkrim të Zyrtarëve të Lartë të Ngarkuar, Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet të i jepet autoriteti për emërim dhe pa ndonjë vonesë të anëtarit të zëvendësuar nga përbërja e Këshillit Drejtues.

#### **Neni12**

Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet ti jepet autoriteti për shkarkim të Zyrtarëve të Lartë të Ngarkuar, çdo kryesuesi të përkohshëm të organeve qeverisëse të UP dhe sekretarëve të fakulteteve në rast të fajësisë dhe mospërputhshmërisë me procedurat dhe dinamikën ashtu si thuhet me lartë në këtë udhëzim. Para shkarkimit duhet të merret një opinion nga Komisioni Qendror Zgjedhor.

#### **Neni 13**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi më datën 26.04.2006

---

**Agim Veliu,**  
**Ministër i Arsimit, Shkencës**  
**dhe Teknologjisë**